



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Municipal Istog
Municipal Istog

Drejtoria për Arsim

05.Nr.364/19

Datë: 31.05.2019

Drejtoria për Arsim në Komunën e Istogut dukë u bazuar në neni 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 35 të Ligjit Nr.04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr.03/L-068 Për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës, dhe në mbështetje të: UA-MPMS, Nr.07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, UA-MASHT, nr.10/2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, si dhe Rekomandimit të Inspektoriatit të Punës Nr.119/19 të datës 17.05.2019 bënë këtë;

RISHPALLJE TË KONKURSIT

Për plotësimin e vendit të lirë të punës

Në shfmu "Trepça" në Banjë.

Titulli i vendit të punës :Një mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilin e plotëson kandidati,
- Rezymeja personale (CV),
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit),
- Çertifikata e lindjes jo me e vjeter së 6 muaj.
- Kopja e diplomës e vërtetuar, ose certifikata në vend të diplomës e vërtetuar jo me e vjeter së gjashtë muaj çdo çertifikat me e vjeter së gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasyshë.
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet ti kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
- Dëshmitë e rikualifikimeve dhe trajnimeve të akredituara nga MASHT (nëse ka)
- Dëshmia që nuk jeni nën hetime jo me e vjetër së 6 muaj
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim (nëse ka)

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-032) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it (UA Nr.10/2018) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Afati i konkursit mbetet i hapur prej datës 31.05.2019 deri më datën 14.06.2019.
Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në hyrje të ndërtesës së Komunës, zyra Nr.100,kati përdhësë dhe dorëzohet i plotësuar së bashku me dokumentacionin përcjellës po në të njëjten zyre.

Dokumentacioni duhet të jetë në kopje,Komisioni i pranimi në rast dyshimi do të kërkon origjinalin në intervistë. Ky dokumentacion shërben deri në përfundim të procedurës së konkursit i njëjti nuk kthehet dhe as nuk ruhet. Dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai i cili arrinë pas afatit nuk do të shqyrtohet gjithashtu kandidatët të cilët nuk e plotësojnë qartë dhe saktë formularin e aplikimit(kërkesën) do të refuzohet.

Në testin me shkrim do të ftohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriterët bazuar në aktet normative dhe legjislacionin në fuqi,kurse intervistes do të nenshtrohen vetëm kandidatët të cilët arrin të kenë me shumë së 50% të kalushmeris se testit më shkrim.

Drejtori i DKA-së
Hajrush Shoshi

